



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1765/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimeve të Kolegjit Universum kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 - *Biomjeksi Laboratorike BSc 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 - *Dizajn Enterieri Bachelor Profesional 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit Universum kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 - *Dizajn Grafik Bachelor Profesional 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
 - *Gazetari Dixhitale Bachelor Profesional 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Universum kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji Universum kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

Faqe 1 nga 3

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Universum kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditim dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A)</i>	Flamur Hasimi Qendrim Maloku Nazife Hajdini Arjeta Gashi Fazli Redon Jashari
2.	<i>Biomjekësi Laboratorike BSc 180 ECTS (A)</i>	Dua Danjulli Shkelzen Elezaj Riaz Agahi Arianit Gashi
3.	<i>Dizajn Enterieri Bachelor Profesional 180 ECTS (A)</i>	Gazmend Uka Erona Jakaj Rinë Kuçi Isufi Besart Avdyli
4.	<i>Higjienë Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R).</i>	Marigona Dermaku Arianit Emra Rozafa Troni Albert Sylja
5.	<i>Dizajn Grafik Bachelor Profesional 180 ECTS (R).</i>	Valbona Gashi Edon Muhaxheri Artan Xhakli
6.	<i>Gazetari Dixhitale Bachelor Profesional 180 ECTS (R)</i>	Merita Miftari Donjeta Nikci Venera Radoni Afet Bela

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum kampusi kryesor me ekipet në përbërje: Antonio Pozo, Jadranka Pelikan, Alan Brickwood, Diana Milcic, Adrian Stan, Alan Brickwood, Majda Tafra dhe Juraj Bogat

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:



1. **Për programin e studimit; Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
2. **Për programin e studimit; Biomjekësi Laboratorike BSc 180 ECTS (A)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 22.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
3. **Për programin e studimit; Dizajn Enterieri Bachelor Profesional 180 ECTS (A)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Dizajn Grafik Bachelor Profesional 180 ECTS (R)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 22.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.
6. **Për programin e studimit; Gazetari Dixhitale Bachelor Profesional 180 ECTS (R)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 22.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Universum kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë